

EKSPLORO TURIZMIN KULTUROR TË KAVAJËS!



EKSPLORO TURIZMIN
KULTUROR TË KAVAJËS!





EKSPLORO TURIZMIN KULTUROR TË **KAVAJËS!**





Funded by
the European Union



Kjo broshurë u prodhua nga Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes në kuadër të projektit “PromoKULT- Zhvillimi i turizmit kulturor në Bashkinë Kavajë” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës.

Përmbajtja e tij është vetëm përgjegjësi e Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Familjes dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian/UNOPS.

Copyright © Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes 2023



Aplikimet e lejes për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose pjesë të këtij publikimi duhet të bëhen në zyrën e Qendrës Shqiptare për Zhvillimin e Familjes:

Rr. Loni Lorigi, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap. 10, Tiranë

E-mail: infoacfdalbania@gmail.com

Website: www.acfd.org.al

Bashkia Kavajë.....	5
HISTORIA DHE ATRAKSIONET KULTURORE PËR T'U VIZITUAR NË KAVAJË.....	7
➤ Pak historik	7
➤ Atraksionet kulturore	8
➤ Tradita dhe kultura.....	16
➤ Etnografia	18
➤ Gastronomia	20
➤ Feja	22
➤ Festat dhe ngjarjet lokale	22
Si shkohet aty?.....	25
Eksploroni Kavajën dhe zonat përreth saj, përmes itinerareve turistike	27





EKSPLORO TURIZMIN KULTUROR TË KAVAJËS!



Bashkia Kavajë

Bashkia e Kavajës bën pjesë në qarkun e Tiranës. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 19.880 ha dhe ka 5 njësi administrative (Kavajë, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas) në të cilat ndodhen 32 fshatra. Që nga viti 1990, bashkia është ndikuar shumë nga lëvizja e popullsisë në zonat më urbane dhe më të zhvilluara.

Bashkia e Kavajës kufizohet në veri me bashkinë e Durrësit, në lindje me bashkinë e Tiranës, në jug me bashkinë e Rrogozhinës dhe në perëndim me detin Adriatik.

Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kavajës. Bashkia pozicionohet në mes të dy poleve kryesore ekonomike në Shqipëri, që është zona ekonomike e Tiranës dhe ajo e Durrësit, gjë që i jep bashkisë Kavajë mundësinë që të rritet ekonomikisht dhe të zhvillojë potencialet e saj. Ndërkohë, klima mesdhetare dhe formacionet gjeologjike bëjnë të mundur zhvillimin e bujqësisë, dhe largësia e shkurtër me detin Adriatik së bashku me peizazhet e bukura i jep bashkisë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e sektorit të turizmit.





- Bashkia e Kavajës është një nga njësitë e qeverisjes vendore të Qarkut të Tiranës.
- Ka 5 njësi administrative: Kavajë, Synej, Luz i vogël, Golem, dhe Helmas, me 32 fshatra.
- 40,094 banorë, sipas Censurit 2011
- 79,445 banorë, sipas Regjistrimit Civil
- Sipërfaqe prej 198.81 km², dhe me densitet prej 400 banorë/km², sipas Regjistrimit Civil
- 55.6 km nga Kryeqyteti i vendit, Tirana
- 47 km nga Aeroporti Nënë Tereza



HISTORIA DHE ATRAKSIONET PËR TË VIZITUAR NË KAVAJË¹

Pak historik

Për sa i përket emërimit të qytetit të Kavajës me emrin aktual, dokumenti i parë që është përdorur është Regjistri i Tokës i Sanxhakut të Shqipërisë i vitit 1431-1432², botuar nga studiuesi turk Halil Inalçik. Sipas këtij regjistri, ky vendbanim (i Kavajës) bënte pjesë në vilajetin e Balshave, në nahinën e quajtur Tomonishte dhe quhej fshati Kavalje me 16 banesa.

Kavaja njihet për objektet e saj të trashëgimisë kulturore, të cilat zënë një vend të veçantë në kulturën dhe historinë tonë kombëtare, si Xhamia Kubelie, Kulla e Sahatit, Muzeu Etnografik etj³.

Kavaja është një qytet i krijuar mbi baza të forta historike dhe kulturore dhe krijimi i saj nuk është i rastësishëm. Qyteti i Kavajës shquhet për zhvillimin e artizanatit, traditës, folklorit (këngë dhe valle) dhe sportit. Sipas të dhënave dhe studimeve historike Kavaja është një qytet i krijuar 500 vite më parë, dhe u bë një qendër e madhe tregtare dhe administrative kryesisht gjatë shekujve XVII – XVIII.

Qyteti i Kavajës ka një histori, kulturë të lashtë dhe një traditë të pasur në mjeshtëri, artin figurativ dhe dekorativ, që daton nga periudha e parahistorisë dhe ka vijuar deri në periudhën e ilirëve. Kjo

¹ <https://qarkutirane.gov.al/trashegimia-kulturore/>

² Halil Inalçik, "Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid" viti 1954

³ Më poshte ju mund të lexoni një përshkrim më të detajuar të monumenteve të kulturës në Kavajë;



traditë vjen deri në ditët tona me prodhimet e bukura të qeramikës të artizanëve kavajas, ku spikasin vazot e mëdha për lule apo vazo dekorative. Punimet në filigran, argjend e bakër janë po ashtu një traditë e lashtë në rrethin e Kavajës, dalluar për prodhimin e bizhuterive prej argjendi ose bakri me filigran. Ndër prodhimet më karakteristike të rajonit janë edhe ato të gdhendjes dekorative të drurit, veçanërisht gypave shumëngjyrëshe, kungujve dhe pjatave dekorative. Qëndistaria ka qenë një zeje mjaft e përhapur dhe e përpunuar në territorin e Kavajës.

Veshjet popullore kavajase, janë pa dyshim një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato janë trashëguese të shumë elementëve, që vijnë nga lashtësia, por janë njëkohësisht edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me kultura të tjera gjatë shekujve. Elementët e veshjeve tradicionale nga këtë rajon dallohen për nivelin e lartë të mjeshtërisë dhe finesës, për pasurinë e zbukurimeve dhe simboleve të shkrira në forma të ndryshme gjeometrike, zoomorfe dhe antropometrike.



Falë disa projekteve të lidhura me trashëgiminë kulturore, disa prej tyre të realizuara, dhe disa në proces zbatimi, zejet e zonës aktualisht po marrin vëmendje dhe po bëhet përpjekje që ato të dalin nga faza e zhdukjes së tyre.



Atraksionet kulturore në qytetin e Kavajës⁴

Në qytetin e Kavajës ka disa objekte dhe monumente të trashëgimisë kulturore shumë të rëndësishme në fushën e historisë dhe kulturës lokale dhe kombëtare.



⁴ Lista e monumenteve të kulturës, Qarku Tiranë: <https://iktk.gov.al/site/pasuri-kulturore/>



Xhamia Kubelie është një prej xhamive më të njohura në qytetin e Kavajës. Xhamia ndodhet në qendër të qytetit dhe ka një arkitekturë shumë të bukur. Xhamia është një vend shumë i rëndësishëm për besimtarët myslimanë dhe një vend shumë i frekuentuar nga turistët vendas dhe të huaj, sidh nga banorët e qytetit. Në vitin 1736 undërtuanga osmani Kapllan Beunjë xhami me emrin “Xhami i Javjetër”⁵; me vendndodhje në rrugën kryesore të qytetit të Kavajës dhe afërsisht 70 metra larg nga xhamia e sotme Kubelie. Xhamia e vjetër u shkatërrua, bashkë me shumë xhami e kisha të tjera, nga regjimi komunist në vitin 1967. Kubelia lindi për të zëvendësuar ndërtesën e vjetër të kultit.



Kulla e Sahatit është një prej atraksioneve më të njohura turistike në qytetin e Kavajës. Kulla është ndërtuar në vitin 1930 dhe është një ndërtesë shumë e bukur me një arkitekturë unike. Kulla është një simbol i rëndësishëm i qytetit të Kavajës dhe një vend shumë i frekuentuar nga turistët dhe banorët e qytetit. Kulla është një ndërtesë e lartë me një planimetri katrore, e ngjashme me një minare të Afrikës së Veriut, por gjithsesi krejtësisht evropiane nga pamja dhe nga hollësitë e tjera. Ajo është një vepër ndërtimore e dekadave të fundit të shekullit XIX. Ndër elementët osmane të saj është dhe një kamare në mur, që përmban një mbishkrim me vetëm një fjalë “Barekallah” (Allahu e begatoftë) dhe vitin 1232 H (1817).

⁵ Ferit Duka, “Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI - vitet 20 të shek. XIX”, 1959



Kisha e Shën Mërisë është një prej objekteve më të rëndësishme kulturore të qytetit të Kavajës. Kisha ndodhet në qendër të qytetit dhe është një ndërtesë shumë e bukur me një arkitekturë unike. Historiku i kësaj kishe fillon që në shekullin e 17-të, kur u ndërtua në vendin





e një kisha tjetër të vjetër. Kisha e Shën Mërisë është një prej kishave më të vjetra të qytetit të Kavajës dhe ka një rëndësi të veçantë për banorët e qytetit. Kisha është rikonstruktuar në shumë raste, por ende ruan një karakteristikë të veçantë historike dhe kulturore.

Historia e Monumentit të Dëshmorëve fillon në vitin 1943, kur forcat partizane shqiptare filluan një luftë të ashpër kundër pushtuesve gjermanë. Në këtë kohë, shumë qytete dhe fshatra shqiptare u bënë objekt i sulmeve dhe grabitjeve nga forcat gjermane. Në vitin 1944, forcat partizane shqiptare arritën të çlirojnë qytetin e Kavajës nga pushtuesit gjermanë. Gjatë kësaj periudhe, shumë njerëz u sakrifikuan në luftën për liri dhe pavarësi. Në vitin 1972, në kujtim të dëshmorëve të Kavajës, u ndërtua Monumenti i Dëshmorëve. Monumenti është një simbol i kujtesës dhe i nderimit për dëshmorët e Kavajës dhe për luftën për liri dhe pavarësi të Shqipërisë.

Varrezat e Dëshmorëve në Kavajë janë një vend i rëndësishëm i kujtesës dhe nderimit për dëshmorët e Kavajës dhe të gjithë Shqipërisë.

Varrezat ndodhen në një vend të qetë në afërsi të qytetit të Kavajës. Varrezat u ndërtuan në kujtim të dëshmorëve të luftës për liri dhe pavarësi të Shqipërisë. Në këto varreza prehen dëshmorët e Kavajës dhe të gjithë Shqipërisë, të cilët sakrifikuan jetën e tyre për liri dhe pavarësi. Varrezat janë një vend i rëndësishëm për banorët e Kavajës dhe për vizitorët, duke u ofruar një mundësi për të reflektuar dhe për të nderuar dëshmorët.

Muzeu Etnografik në Kavajë është një vend shumë i rëndësishëm për të njohur traditat dhe kulturën e Kavajës dhe të gjithë Shqipërisë. Muzeu Etnografik u ndërtua nga fundi i shek. të XVIII-të dhe fillimit të shek. të XIX-të nga familja Arkaxhi dhe u hap si muze në vitin 1971. Pas restaurimit të plotë të godinës, muzeut të sapo krijuar iu dha statusi Monument i Kulturës, në vitin 1973. Muzeu ndodhet në lagjen Skuraj të qytetit të Kavajës, me sipërfaqe 434 m², i rrethuar nga një mur i ulët me tulla dhe kangjella çeliku dhe ofron një koleksion të pasur të artikujve të vjetër dhe tradicionalë. Banesa ka një zhvillim simetrik, ku boshti i simetrisë kalon nga mesi i verandës ballore, e cila është e mbuluar dhe ka një portik dhe mbahet nga shtatë kolona druri. Muzeu është një nga banesat më karakteristike të zonës. Ai i përket tipologjisë së ndërtesave tradicionale, ku përdorimi i hapësirës është projektuar rreth një numër verandash, me tre dhoma banimi. Ai është rrethuar nga shtëpi të tjera relativisht të ulëta, një, dy ose tre katëshe.





Në muze ka aktualisht mbi 7000 objekte të ekspozuara. Në muze ka një larmi të madhe të artikujve artizanale, tradicionalë, të prodhuara nga zejtarët vendas në qeramikë, bakër dhe tekstile të ndryshme, që përfaqësojnë traditat kavajase dhe të vendit. Këto objekte përfshijnë artikuj të vjetër të ndryshëm si: veshje tradicionale, këpucë, këmisha, këmisha të brendshme, kapele, etj.

Ka shumë artefakte autentike dhe me vlerë, përfshirë kostume folklorike dhe objekte të tjera etnografike që datojnë nga periudha ilire, 1400 -1600 (mesjeta e hershme), 1831-1912 (Rilindja), 1912-1939 (Pavarësia), 1945-1990 (Periudha Socialiste). Objekti është restauruar nga Programi EU4Culture, një nga programet më të mëdha për trashëgiminë kulturore të Bashkimit Evropian, i cili po zbatohet në Shqipëri nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës.



Ndërtesat e vjetra

Depo e kripës mesjetare: Pozicionohet në veri-perëndim të qytetit të Kavajës, pranë bregut të detit Adriatik. Kjo gjë i ka dhënë mundësinë që në lashtësi për krijimin dhe vendruajtjen e kripës së detit. Është e vetmja magazinë kripe në Shqipëri e këtyre përmasave që ka mbijetuar deri në ditët tona, me vlera të padiskutueshme historike dhe arkitekturore. Për vlerën dhe rëndësinë që mbart magazina e kripës, është shpallur monument kulture i kategorisë së parë, në vitin 1984.

Vepra ndërtimore të periudhës komuniste: Periudha komuniste në Shqipëri u shtri nga viti 1945 deri në vitin 1991. Veprimtaria ndërtimore gjatë kësaj periudhe kishte karakter bujqësor dhe ekonomik si digat e shumë ujëmbledhësve të ndërtuar për të siguruar sasinë e nevojshme të ujit aq të domosdoshëm për bujqësinë, kanale kullimi vaditjeje, vepra bonifikimi, hidrovorë, ujësjellësa, magazina dhe ndërtesa të tjera ndihmëse të ish-kooperativave dhe me karakter ushtarak si: bunkerë të llojeve dhe përmasave të ndryshme, transhe, tunele dhe reparte ushtarake.

Për një eksperiencë më të veçantë, të gjitha objektet e trashëgimisë kulturore të bashkisë Kavajë të pasqyruara në këtë broshurë mund t'i vizitoni nëpërmjet Turit Virtual 360 gradë <https://acfd.org.al/projekte/promokult/> të realizuar në kuadër të projektit "PROMOKULT-Development of cultural tourism of Kavaja Municipality", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës





TRADITA DHE KULTURA⁶

Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare, e njohur për prodhimet në tezgjah, poçerinë dhe fabrikën e qelqit. Pas mbylljes së fabrikave, qytetit i kanë mbetur shumë pak njerëz që i trashëgojnë këto profesione. Një traditë e lashtë e banorëve të kësaj zone është punimi i gurit dhe sidomos i alabastrës.



Kavaja shquhet për prodhimet e gdhendjeve dekorative të drurit, ku ndër produktet më karakteristike me dru janë: pjatat dekorative, llulat dhe pagureve. Qëndisja në trevën e Kavajës ka zënë një vend të konsiderueshëm në zanatet e përdorura nga vajzat dhe gratë e zonës, të cilat shquheshin për qëndisimat e bukura dhe fine të punuara me fije mëndafshi, ari dhe argjendi.

Një nga aktivitetet e veçanta është prodhimi i bizhuterive prej argjendi ose bakri me filigran si dhe ato të gdhendjes dekorative të drurit. Për më tepër, një zeje shumë e pranishme mes zejtarëve ka qenë dhe mbetet kallaji.



Veshjet tradicionale të Kavajës

Në zonën e Kavajës, gjejmë objekte të përdorimit të përditshëm si: kostume popullore, veshje, pjata, mobilje, vegla pune etj. Punimet e tekstilit i gjejmë në dy kategori; *në veshje fshatare*, motivet e të cilave karakterizohen me motive gjeometrike, dhe në *veshje të qytetit*, ku shpesh nuk mungojnë motive të shprehura me forma vegjetale ose zoomorfe. Dallimin mes dy kategorive e bën edhe ndërthurja e ngjyrave dhe teknika e punimit të tekstilit, ku në rastin e parë puna bëhet me qëndisje dhe në rastin e dytë ato kanë një endje të imët dhe punë më delikate.

Përpunimi dhe dekorimi i xhamit

Një departament tjetër me emër në Kavajë ishte ai i "Përpunimit dhe dekorimit të qelqit", ku në sektorin e dekorimit u punësuan shumë gra dhe vajza të zonës, të cilave u janë kushtuar poezi e këngë dhe janë pjesë e kujtesës dhe trashëgimisë shpirtërore jomateriale të zonës së Kavajës.

Në të kaluarën, në tregun e qytetit, nën Kullën e Sahatit, e cila ishte plot me dyqane të vogla artizanale dhe prodhimesh vendase, dëgjohej zhurma e çekiçit të teneqexhinjve, që binte mbi kazanët, tepsitë apo kazanët e mëdhenj për prodhimin e rakisë, që ustallarët e Kavajës e punonin me kujdes. Fatmirësisht, ky është një zanat që ekziston ende dhe praktikohet tashmë në lagjen





periferike të lagjes Sallbeg, përgjatë rrugës Egnatia. Në dyqanet përgjatë rrugës mund të shihni edhe objekte të tjera interesante prej alumini, duke përfshirë edhe fuçitë e rakisë, e cila është një pije karakteristike në Shqipëri dhe prodhohet tradicionalisht me këto objekte specifike prej bakri dhe alumini. Gjithashtu, objekte dekorative prej bakri dhe alumini prodhohen ende nga artistë dhe artizanë të pasionuar, të cilët nuk kanë hequr dorë nga ky pasion dhe besimi se një ditë përmes zhvillimit të turizmit do të mund të ofrojnë veprat e veçanta dhe origjinale për turistët.

Porta Jugore

Kavaja njihet edhe si “Porta e Jugut” e hyrjes në Shqipërinë e Mesme. Kavaja ka qenë një stacion i njohur në histori në rrugën Egnatia që lidhte perëndimin me lindjen. Një pikë që mbart karakterin historik të zonës është vendndodhja Asparagus, pranë lumit Shkumbin dhe Bashtovës, ku ndodheshin kampet e ushtrive të Çezarit dhe të Pompeit. Më tej, beteja përfundimtare u zhvillua në jug të Durrësit, diku pranë Shkëmbit të Kavajës, ku ushtria e Pompeut thyen ushtrinë e Çezarit, duke e zënë rob një pjesë të tij. Ka teza dhe supozime se toponimi Mali i Robit e ka origjinën pikërisht nga ky fakt i lashtë historik.

ETNOGRAFIA

Në Kavajë, historia e mjeshtërisë lidhet me parahistorinë. Nga epoka e bronzit deri në qytetërimin e lashtë ilir, arti dekorativ dhe figurativ u shtri edhe në zejet ilire. Qeramikat e pikturuara dëshmojnë për shijen e hollë artistike të artizanëve ilirë.

Kavaja, si pjesë e Shqipërisë së Mesme, ka shumë karakteristika etnografike të ngjashme në folklor, krijime dialektore e muzikore, valle, kostumografi dhe kulturë materiale me Tiranën, Elbasanin apo Durrësin.



Veshjet popullore lokale

Zona e Kavajës, e cila i përket Shqipërisë së Mesme, përcjell veçori karakteristike të lidhura me etnografinë, shumë të përafërta me zona të tjera si Elbasani, Tirana dhe Durrësi. Kryesisht këto veçori janë të lidhura me trashëgiminë kulturore jomateriale (vallet, gastronomia, kostumografia etj).

Nga kjo trashëgimi kulturore mund të veçohet veshja e bukur tradicionale popullore e burrave dhe grave të zonës. Veshja e grave kishte kryesisht dimitë me ngjyrë të bardhë dhe me qëndisma, këmishë dhe jelek. Ndërsa në kokë vendosnin një shall ose një kapak të zbukuruar me monedha dhe me qëndisje. Ndërsa burrat vishnin kostum me pantallona, këmishë të bardhë, jelek të kuq të qëndisur ose xhaketë me ngjyrë të zezë, si dhe vendosnin një rrip leshi në brez.

Punimet artizanale

Zona e Kavajës spikat kryesisht për punimet tekstile, ku mund të përmendim sixhadet. Materialet për shtroje përdornin kryesisht leshin. Sot kjo traditë vazhdon të ruhet nga gratë artizane të Kavajës.





Produktet bimore

Ashtu si edhe në shumë zona të ndryshme fushore, malore dhe bregdetare të Shqipërisë kanë përdorur materiale të ndryshme si lirin, dëllinjën, leshin dhe kërpën, edhe në Kavajë me zhvillimin ekonomik dhe fillimin e industrializmit, edhe fija e pambukut mori një përdorim të gjerë. Prodhimi i shtratit me fije pambuku hyri në përdorim të gjerë. Pas viteve 1941 në disa qytete si: Tiranë, Korçë, Kukës, Berat, por edhe në Kavajë, u krijuan kooperativa artizanale për “Punën e Leshit”, ku qilimat kishin një seksion të veçantë.



GASTRONOMIA DHE VERA ARTIZANALE LOKALE

Zona e Kavajës është e shquar për prodhimet e saj të shumëllojshme, ku dallohet kryesisht për pemë frutore: si: arra, ullinj, hurma, fiq, pjeshkë, shegë, mandarina, portokalle, vreshta me rrush, Gjithashtu këtu gjejmë edhe kultura të tjera (fusha me jonxhë, bimë mjekësore të ndryshme) që lidhen me kushtet klimatike dhe pozicionin e saj gjeografik. Zona e

Kavajës vazhdon të ruajë një traditë në fushën e gastronomisë, duke zënë një vend mjaft të rëndësishëm për vendasit dhe turistët lokal dhe të huaj që e vizitojnë zonën.



Produktet organike

Zona e Kavajës ka të zhvilluar bujqësinë dhe blegtorinë. Ajo ka ekonomi bujqësore tradicionale si stalla, mbarështimi i bagëtive të imta e të mëdha, fermë për kultivimin e kërmijve, si dhe një fermë për rritjen e kuajve. Kavaja ka emër për prodhimin e bulmetit (produktet e qumështit), ku përmendet për prodhimin e kosit. Për prodhimin e tij përdoren enë prej balte (qeramike), të cilat zënë përdorim të gjerë në kuzhinë. Përdorimi i tyre ka sjell përfitime jo vetëm në prodhimin e një produkti me shije dhe cilësor, por edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Vera artizanale

Kultura e prodhimit të varieteteve të rrushit e ka bërë këtë zonë të njohur për prodhimin e verës artizanale. Këtu mund të përmendim kantinën “Belba”, e cila prodhon verëra cilësore artizanale. Vera është shoqëruese e gatimeve të amvisave me prodhimet bio si: gatimet e mishit të qingjit, mish viçi, shpend dhe gjel deti, çervish, fërghesa, qeshkek dhe byrekë të ndryshëm. Kavaja njihet si një nga qytetet që gatuan me mjeshtëri byrekun me qumësht, i cili përgatitet zakonisht për festa të mëdha.





FEJA

Shumica e banorëve të bashkisë së Kavajës, si dhe fshatrave përreth saj i përkasin besimit mysliman, prandaj festat kryesore të kalendarit mysliman kanë një rëndësi të madhe në jetën dhe përditshmërinë e banorëve të këtij komuniteti. Gjithashtu, numri më i madh i objekteve të vjetra dhe moderne fetare (xhamitë) i përkasin pikërisht myslimanëve. Megjithatë, duhet nënvizuar fakti se, si në të gjithë vendin tonë, edhe në Kavajë ka komunitete të tjera fetare, më të vogla në numër, si të krishterë katolikë, ortodoksë, ungjillorë, protestantë etj. Bashkëjetesa fetare në të gjithë hapësirën e sipërpërmendur, si dhe në të gjithë territorin shqiptar, është një fakt dhe vlerë e mbartur në shekuj.

FESTAT DHE NGJARJET LOKALE



Festa e Shën e Premtes është një festë e cila festohet nga të gjithë vendasit pa dallim besimi fetar. Ajo celebrohet 3 ditë pas festës së Pashkëve. Në këtë ditë ata dalin për piknik në kodrat e Çetës dhe urojnë njëri-tjetrin me urimin “Pranvera me bollëk dhe harmoni”.

Dita e Plisave është një festë pagane, nuk e qartë origjina e saj, por mënyra e festimit të saj është ende e ruajtur nga vendasit. Kjo festë festohet dy javë para ardhjes së Ditës së Verës. Gjatë kësaj dite fëmijët

dalin çdo mbrëmje dhe këndojnë në dyert e shtëpive këngën e Llaxoreve, e cila uronte fat dhe bereqet për të gjithë anëtarët e familjes lidhur me ngjarje të ndryshme të jetës.

Mbrëmja e 13 Marsit, gjatë kësaj nate vendasit varnin një degë të këputur nga pema e ullirit në derën e shtëpisë, gjë që simbolizonte fat, si dhe vendosnin në duar verore të përgatitura me penj ngjyrë të bardhë dhe të kuqe, që simbolizonte fat dhe shëndet. Kjo festë është shumë e parapëlqyer edhe për fëmijët, të cilët mezi e presin dhe ndjejnë kënaqësi.

Videoklipi 'Eja në Kavajë' është një ftesë për të zgjedhur e për të vizituar pikërisht Kavajën jo vetëm gjatë sezonit turistik por edhe për një fundjavë të mrekullueshme!

Kjo video u prodhua në kuadër të projektit "PromoKULT- Zhvillimi i turizmit kulturor në bashkinë Kavajë" i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.





Travel terms

aeroplane - avion

airport - aeroport

Car—veturë, makinë

Bus—autobus

Is it far—A është larg?

Left—majtas

Right—djathtas

Where am I? —ku jam?

City — qytet

NUMRAT E EMERGJENCEVE/ SOS

 127 AMBULANCA	 128 ZJARRËFIKËSE
 129 POLICIA E SHTETIT	 125 QENDRA NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE
 Frekuenca VHF-16 KAPITENERIA DETARE	 112 SHËRBIMI I EMERGJENCËS

Numri prefiks i Shqipërisë +355

KODI POSTAR KAVAJE 0554 (+355 554)


Çfarë mund të bëni në Kavajë?

**Eksploron natyrën dhe bregdetin!
Vizitoni shtet kulturore dhe historike!
Shijoni gastronominë!**





Si shkohet aty?



Udhëtimi për në Kavajë: Kavaja është një vend i bukur bregdetar në Shqipëri, me një mjedis të mrekullueshëm, ku gjenden atraksione të ndryshme si: plazhe pjesërisht ranore e pjesërisht shkëmbore, bukuri të tjera natyrore si dhe monumente të trashëgimisë historike dhe kulturore materiale dhe jomateriale. Në këtë broshurë, do të zbuloni se në cilat mënyra mund të arrini dhe eksploroni këtë destinacion unik, si dhe itineraret turistike

Transporti:

Ju mund të arrini në Kavajë me autobusë, taksi, makinë me qera nga shumë rajone, nga e gjithë Shqipëria për çdo ditë. Udhëtimi nga Tirana në merrni autostradën drejt Durrësit dhe më pas daljen

Kavajë zgjat rreth **1 (një) orë**, duhet të merrni autostradën drejt Durrësit dhe më pas daljen e Kavajës.



Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut TIRANË:

Oraret e nisjes së autobusave për në Kavajë:

07:00 a.m; 08:30 a.m; 10:00 a.m; 12:00 a.m; 14:00 p.m; 15:00 p.m; 17:00 p.m;

Pë më shumë informacion mund të vizitoni faqen: <https://tirana.al/pika-interesi/terminali-i-autobusave-te-jugut-dhe-veriut>

**MOS HARRONI TË INFORMOHENI PËR MUNDËSITË E TRANSPORTIT LOKAL QË KENI,
MËNYRËN QË TË ORGANIZONI TRANSFERIMIN NË HOTELIN TUAJ DHE TË EKSPLORONI
KAVAJËN ME LEHTËSI!**



Ju mund të eksploroni Kavajën dhe zonat përreth saj, përmes itinerareve turistike

Itinerari I – Shtegu mes kodrave

Itinerari II- Shtegu i Liqeneve

Itinerari III – Shtegu i Pishave

Itinerari IV – Shtegu Venecian

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen zyrtare <https://routes4culture.com/>

Ky website është krijuar nga organizata AULEDA, në kuadër të programit EU4Culture të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.

